

ORGANIZATA JO-QEVERITARE “EMANCIPIMI CIVIL MA NDRYSHE” (EC Ma Ndryshe)

STATUTI

Ky statut do te qeverisë shoqatën jo-profitabile “ Emancipimi Civil Ma Ndryshe”, të themeluar në pajtim me Rregulloren numër 1999/22 të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Neni 1 – Emri, forma dhe adresa

1.1. Organizata do të quhet Organizata Jo-Qeveritare “Emancipimi Civil Ma Ndryshe”.

1.2. Ajo mund të njihet edhe si “ EC Ma Ndryshe”.

1.3. Organizata është shoqatë jo-profitabile, sipas definimit të dhënë në paragrafin 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut numër 1999/22.

1.4. Organizata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo fitimi neto ose të profitit si të tillë për asnjë individ. Pasuria, të ardhurat dhe profiti i organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet joprofitabile të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar beneficione të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të dretëpëdrejtë apo indirekte për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësin, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së. Megjithatë pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona kanë bërë për këtë organizatë.

1.5. Ndonjë transakcion në mes të anëtarëve, anëtarëve të Bordit Udhëheqës, personi ose nëpunësi dhe organizatës duhet të mbyllet në vlera reale të tregut ose në kushte që janë më të favorshme për organizatën.

1.6. Organizata e ka zyrën e saj qendrore në Prizren, Saraçët 5, 20000.

Neni 2 – Themeluesit

2.1. Themelues të organizatës janë:

- Festim Fishekçiu, Rr.Komuna e Parisit 2/5 Prizren
- Festim Nevzati, Rr.Beteja e Llapushnikut 7/3 Nr.16 Prizren
- Edon Mullafetahu, Rr.Shtjefën Gjeçovi Nr.54 Prizren

2.2. Përfaqësues i autorizuar i organizatës në Kosovë është, sipas detyrës zyrtare, Drejtori Ekzekutiv i organizatës. Për zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv, respektivisht përfaqësuesit të autorizuar të organizatës, duhet të njoftohen organet kompetente, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

2.3. Drejtori Ekzekutiv emërohet nga Kuvendi i Anëtarëve dhe duhet të përfaqësojë organizatën në Kosovë dhe pranojë të gjitha shkresat zyrtare në emër të organizatës. Ai ose ajo duhet të jetë përgjegjëse për informimin e autoriteteve relevante administrative për çfarëdo ndryshimi në organizatë.

Neni 3 – Qëllimi

3.1. Organizata do të angazhohet për të shtyrë parapra qëllimet e: promovimit të qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse në proceset shoqërore, promovimit dhe ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore, promovimit dhe ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për mbrojtjen dhe kultivimin e mjedisit, avancimit të pozitës së rinisë në proceset vendimmarrëse, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, promovimit të drejtësisë sociale dhe kontribuimit në procesin e integritit të Kosovës në strukturat evropiane nëpërmjet vlerave kulturore, shoqërore, qytetare dhe politike të vendit tonë.

3.2. Për t’i përmbushur qëllimet e saj, organizata do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetëm në to, aktivitetet e poshtëshënuara:

- Aktivitete kulturore (mbrojtja dhe kultivimi)

- Aktivitete sociale (promovimi i drejtësisë sociale)
- Aktivitete mjedisore (mbrojtje dhe promovim)
- Aktivitete për të drejtat e njeriut (mbrojtja dhe promovimi)
- Aktivitete për qytetari aktive (promovimi i kulturës së pjesëmarrjes)
- Aktivitete për integritet evropiane (promovim dhe kontribuim)
- Hulumente, studime e botime të raporteve hulumtuese dhe publikime tjera
- Tryeza, puëntori e aktivitete të ngritjes së kapaciteteve
- Avokim
- Përkrahje financiare dhe jo-financiare për nisma të komunitetit, organizata të shoqërisë civile dhe subjekte tjera që angazhohen në fushat e veprimit të organizatës
- Aktivitete tjera të ngjashme që përkojnë me natyrën e punës së organizatave jo-qeveritare dhe fushat e punës së organizatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për liri të asociimit dhe ligjet tjera në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 4 – Anëtarësimi

4.1. Anëtarësimi në organizatë është i hapur për çdo person pa marrë parasysh racën, gjininë, orientimin seksual, shtetësinë, kombësinë, religjionin, moshën ose aftësitë fizike.

4.2. Kuvendi i anëtarëve do të vendos nëse do të kërkohet pagimi i anëtarësimi nga anëtarët. Mospagesa e anëtarësisë, pas paralajmërimit të shkruar, do të shërbejë si bazë për marrjen e masave të ndryshme, deri në përjashtimin e anëtarit nga organizata.

4.3. Anëtarësimi i ndonjë anëtari gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e Kuvendit të Anëtarëve në rastet kur aktiviteti dhe deklaratimet e anëtarit të caktuar bien ndesh me statutin dhe politikën programore të organizatës, keqpërdoret pozita dhe emri i organizatës nga anëtari i caktuar, gjë që mund të shkaktojë dëmtim financiar apo të reputacionit të organizatës. Në rast të suspendimit, kohëzgjatja e suspendimit do të përcaktohet.

4.4. Përfundimi ose suspendimi i anëtarësimi nga Kuvendi i Anëtarëve do të vendoset me shumicë të anëtarëve prezent.

Neni 5 – Kuvendi i Anëtarëve

5.1. Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i organizatës. Ai përbëhet prej të gjithë anëtarëve të organizatës.

5.2. Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjet financiare të organizatës.

5.3. Kompetencat kryesore të Kuvendit të Anëtarëve janë:

- të zgjedhë dhe shkarkojë Drejtorin Ekzekutiv të organizatës,
- të zgjedhë dhe shkarkojë Bordin e Ndërmjetëm të organizatës,
- të aprovojë raportet periodike financiare dhe të punës,
- të interpretojë dhe ndryshojë Statutin,
- të kontrollojë mbarëvajtjen e punës dhe atë financiare sa herë që e sheh të nevojshme.

5.4. Kuvendi i Anëtarëve mund të delegojë ndonjë prej përgjegjësive të tij në Bordin e ndërmjetëm ose në ndonjë organ tjetër ose edhe të punësuar të organizatës, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij, përveç kompetencave të rezervuara sipas legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në OJQ.

Neni 6 – Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve

6.1. Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku një herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV) ku do të vlerësojë dhe aprovojë mjetet, obligimet, shpenzimet e të hyrave dhe programet për vitet e ardhëshme.

6.2. Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ) kurdoherë që kërkohet nga gjysma e anëtarëve ose nga Bordi Udhëheqës. Një kërkesë e tillë duhet t'i drejtohet

Menaxherit Operacional i cili do të lajmërojë për takimin të gjithë anëtarët, në pajtim me procedurat e shpjeguara në paragrafin 6.3.

6.3. Lajmërimi me shkrim për MPV dhe/ose MPJ duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për takimin do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku shtatë ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.

6.4. Për mbajtjen e mbledhjes është e nevojshme pjesëmarrja e më së paku gjysmës së anëtarëve. Nëse ky minimum (kuorumi) nuk arrihet takimi do të shtyhet për një ditë të përcaktuar më vonë dhe lajmërimi i ri do t'u dërgohet të gjithë anëtarëve.

6.5. Secili anëtar i organizatës ka një votë në Kuvendin e Anëtarëve.

6.6. Vendimet në Kuvendin e Anëtarëve do të merren me shumicën e anëtarëve prezent.

6.7. Secili anëtar i Kuvendit të Anëtarëve mund të abstenojë nga votimi ose marrja e vendimit në çfarëdo çështje për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.

Neni 7 – Bordi i Ndërmjetëm

7.1. Përpos kompetencave të dhëna me këtë statut, Bordi i Ndërmjetëm është përgjegjës për kontrollin periodik të çështjeve strategjike dhe pasurisë së organizatës. Bordi i Ndërmjetëm duhet të veprojë çdo herë në pajtim me qëllimin e organizatës.

7.2. Përpos kompetencave të dhëna me këtë statut, Bordi i Ndërmjetëm do të ketë gjithashtu edhe këto kompetenca:

- të përfaqësojë organizatën dhe të veprojë në emër të organizatës, kur kërkohet nga Kuvendi i Anëtarëve apo Drejtori Ekzekutiv,
- të emëroj, zgjedh dhe shkarkoj Drejtorin Ekzekutiv,
- t'i përcaktojë kompetencat dhe detyrat e Drejtorit Ekzekutiv,
- të pranojë dhe shqyrtojë raporte nga Drejtori Ekzekutiv për mbarëvajtjen e projekteve dhe aktiviteteve zyrtare të organizatës.

7.3. Bordi i Ndërmjetëm mund të përbëhet nga anëtarët e organizatës apo të tjerë të cilët i ndajnë qëllimet dhe vlerat e njejta me organizatës, dhe nuk mund të ketë më pak se 3 (tre) anëtarë..

7.4. Njëri anëtar i Bordit të Ndërmjetëm është Drejtori Ekzekutiv, sipas detyrës zyrtare, përgjatë gjithë mandatit të tij/saj. Dy anëtarët tjerë të Bordit të Ndërmjetëm zgjedhen dhe/ose shkarkohen nga Kuvendi i Anëtarëve, me mandat 3 vjeçar.

7.5. Drejtori ekzekutiv dhe anëtarët e tjerë të Bordit Udhëheqës mund të zgjedhen për mandate të njëpasnjëshme.

7.6. Drejtori Ekzekutiv i organizatës mund të shkarkohet para përfundimit të mandatit me votat e MPV-së dhe MPJ-së të Kuvendit të Anëtarëve.

7.7. Në rast të vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv, Kuvendi i Anëtarëve duhet të zgjedh pasardhësin për të shërbyer për kohën e mbetur.

7.8. Vendimet në Bordin e Ndërmjetëm merren me shumicë.

7.9. Bordi i Ndërmjetëm mund të vendos t'i drejtohet për çfarëdo çështje Kuvendit të Anëtarëve për marrje të vendimit.

7.10 Kurrëfarë pagese ose kompenzimi nuk duhet t'u bëhet anëtarëve të Bordit të Ndërmjetëm në cilësinë e tyre si anëtarë të këtij Bordi pa aprovimin e Kuvendit të Anëtarëve dhe vetëm kur pagesa ose kompenzimi është i arsyeshëm dhe bëhet për punën e kryer për organizatë.

7.11. Secili anëtar i Bordit të Ndërmjetëm duhet të abstenojë prej votimit për marrjen e vendimeve ose për çfarëdo çështje tjetër për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.

Neni 8 – Zyrtarët dhe Nëpunësit

8.1. Në rast nevojë Bordi i Ndërmjetëm do të emërojë Zyrtarë ose të pranojë persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave ditore të organizatës. Kohëzgjatja e punësimit të tyre duhet të caktohet nga Bordi i Ndërmjetëm, i cili duhet të informojë Kuvendin e Anëtarëve për emërimet të tilla.

8.2. Zyrtarët duhet të punësohen përmes marrëveshjes së shkruar e cila detalizon të gjitha të ardhurat dhe të mirat tjera që duhet t'i paguhen Zyrtarit. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arësyeshme dhe duhet të paguhen vetëm për punën e kryer në organizatë.

Neni 9 – Shpërbërja e organizatës

9.1. Organizata mund të shpërbëhet me vendimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit të Anëtarëve.

9.2. Kur të vendos për shpërbërjen e organizatës, Kuvendi i Anëtarëve do të tregojë emrin e shoqatës apo fonadcionit që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jetë liruar nga detyrimet e organizatës. Shoqata(t) ose fondacioni(et) e zgjedhura duhet të kenë qëllime të njejta ose të ngjajshme sikurse organizata.

Neni 10 – Ndryshimet e statutit

10.1. Statuti i tanishëm mund të ndryshohet me vendimin e dy të tretave të Kuvendit të Anëtarëve.

Neni 11 – Periudhat e Raportimit dhe Viti Financiar

11.1. Bordi Udhëheqës dhe Zyrtarët e emëruar do të paraqesin raporte vjetore para Kuvendit të Anëtarëve, MPV ose kurdoherë që kërkohet nga një MPJ.

11.2. Viti financiar i organizatës do të përputhet me vitin kalendarik.

Ky statut është aprovuar në Prizren , më 14.03.2006 nga Kuvendi i Anëtarëve.